



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.140

30 shtator

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 143 datë 16.9.2009	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.3, datë 10.8.2009 të Këshillit të Ministrave “Për dërgimin në Afganistan të një kompanie shtesë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.....	6395
Vendim i KM nr.885, datë 19.8.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.115, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2009, në disa ministri dhe institucione qendrore” , të ndryshuar.....	6395
Vendim i KM nr.886, datë 22.8.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të disa autokolonave dhe automjeteve ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	6396
Vendim i KM nr.889, datë 19.8.2009	Për miratimin e marrëveshjes së kontributit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, për financimin e projektit të rrugëve dytësore dhe vendore.....	6397
Vendim i KM nr.891, datë 19.8.2009	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Polis të qarkut të Elbasanit.....	6402
Vendim i KM nr.894, datë 19.8.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Ndroq të qarkut të Tiranës.....	6403
Vendim i KM nr.895, datë 19.8.2009	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Kelmend të qarkut të Shkodrës	6404

Udhëzim i MPÇSSHB
nr.1547, datë 27.8.2009

Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në
institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit
shoqëror 6404

Urdhër i MB
nr.642, datë 25.9.2009

Për delegim kompetence 6405

Urdhër i METE
nr.666, datë 3.8.2009

Për miratimin e rregullave teknike dhe kriterëve të sigurisë,
të përkohshme, për kërkesat minimale të projektimit teknik,
ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të
shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së,
hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte 6407

LIGJ
Nr.10 143, datë 16.9.2009

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.3, DATË 10.8.2009
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DËRGIMIN NË AFGANISTAN TË NJË
KOMPANIE SHITESË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.3, datë 10.8.2009 të Këshillit të Ministrave “Për dërgimin në Afganistan të një kompanie shtesë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

**Shpallur me dekretin nr.6266, datë 24.9.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM
Nr.885, datë 19.8.2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.115, DATË 2.2.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOHSHME, PËR VITIN 2009, NË DISA MINISTRI DHE INSTITUCIONE
QENDRORE” , TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1 e vendimit nr.115, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2009, për ministrinë dhe institucionet qendrore, është 2636 punonjës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Grupi	Emri i institucionit	Nr. i punonjësve
02	Kuvendi i Shqipërisë	11
03	Këshilli i Ministrave	1
04	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	58
05	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit	213
06	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	815
10	Ministria e Financave	50
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	113
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	22
13	Ministria e Shëndetësisë	51
14	Ministria e Drejtësisë	31
15	Ministria e Punëve të Jashtme	16
16	Ministria e Brendshme	562
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	40
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	30
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	87
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	140
28	Prokuroria e Përgjithshme	5
30	Gjykata Kushtetuese	2
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	4
50	INSTAT	378
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	2
77	Autoriteti i Konkurrencës	2
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	1
87	Institucione të tjera qeveritare	2
	Totali	2636

VENDIM
Nr.886, datë 22.8.2009

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DISA AUTOKOLONAVE DHE AUTOMJETEVE
USHTARAKE SLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të disa autokolonave ushtarake slovene, në:

a) datën 22 gusht 2009, një autokolonë e përbërë nga 4 (katër) automjete dhe 10 (dhjetë) persona, në itinerarin Morinë-Durrës;

b) datën 23 gusht 2009, 1 (një) autokolone e përbërë nga 2 (dy) automjete dhe 4 (katër) persona, në itinerarin Morinë-Durrës;

c) datën 24 gusht 2009, 3 (tri) autokolona të përbëra, si më poshtë vijon:

i) autokolona e parë nga 2 (dy) automjete dhe 4 (katër) persona;

ii) autokolona e dytë nga 19 (nëntëmbëdhjetë) automjete dhe 37 (tridhjetë e shtatë) persona;

iii) 1 (një) automjet dhe 2 (dy) persona);

Itinerari i lëvizjes së këtyre autokolonave është Durrës-Morinë.

ç) datën 26 gusht 2009, 2 (dy) autokolona, të përbëra si më poshtë vijon:

i) nga 1 (një) automjet dhe 2 (dy) persona, në itinerarin Qafë-Thanë-Durrës;

ii) autokolona e dytë nga 22 (njëzet e dy) automjete dhe 35 (tridhjetë e pesë) persona, në itinerarin Morinë-Durrës;

d) datën 27 gusht 2009, 1 (një) autokolone, e përbërë nga 4 (katër) automjete dhe 9 (nëntë) persona, në itinerarin Durrës-Morinë;

dh) datë 28 gusht 2009, vetëm 1 (një) automjet dhe 2 (dy) persona, në itinerarin Durrës-Morinë.

2. Autokolonat dhe automjetet ushtarake sllovene, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.889, datë 19.8.2009

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONTRIBUTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EUROPËS, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË RRUGËVE DYTËSORE DHE VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së kontributit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Europës, për financimin e projektit të rrugëve dytësore dhe vendore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE KONTRIBUTI

NDËRMJET BANKËS SË KËSHILLIT TË EUROPËS PËR ZHVILLIM DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Banka e Këshillit të Europës për Zhvillim, Organizata Ndërkombëtare, Paris (këtu e quajtur CEB), nga njëra anë, dhe Republika e Shqipërisë (marrësi), e përfaqësuar nga Ministria e Financave (këtu e quajtur MF), si huamarrës i CEB-it për financimin e pjesshëm të projektit F/P 1665 (2009) “Rehabilitimi i rrugëve dytësore dhe lokale” që gjenden në të gjithë vendin, i miratuar nga këshilli administrativ i CEB-it, më 12 mars 2009;

ndërsa me anë të një marrëveshjeje të nënshkruar më 19 prill 2004 dhe marrëveshjet e saj shtesë, CEB-i dhe Mbretëria e Norvegjisë kanë rënë dakord të hapin një llogari besimi në CEB me qëllimin e financimit të aktiviteteve të projekteve të ndryshme që mbështesin reformat sociale dhe ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor, me objektivin përfundimtar të ndihmesës së tyre për t’u përgatitur për anëtarësim të mundshëm në BE;

ndërsa CEB-i, nëpërmjet llogarisë së besimit të Norvegjisë, dëshiron të japë kontribut si grant për marrësin për të siguruar asistencë teknike (këtu të quajtur “Projekti”) për Fondin Shqiptar të Zhvillimit për zbatimin e projektit F/P 1665 (2009) “Rehabilitimi i rrugëve dytësore dhe lokale” që gjenden në të gjithë vendin, siç përmbledhet në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje;

ndërsa, CEB-i dhe marrësi do të lidhin një marrëveshje kuadër huaje (këtu e quajtur FLA) për projektin F/P 1665 (2009) “Rehabilitimi i rrugëve dytësore dhe lokale në shumën 40 000 000 euro që do t’i paraqitet më pas Parlamentit Shqiptar për ratifikim;

dhe ndërsa qëllimi i kësaj Marrëveshjeje ndërmjet CEB-it dhe marrësit është caktimi i termave dhe kushteve në lidhje me transferimin dhe menaxhimin e këtij granti për projektin;

kështu, CEB-i dhe marrësi bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Granti

1.1 CEB-i, në mënyrën e përmendur në paragrafin 1.2 të këtij neni, vë në dispozicion të MF-së shumën prej 180 000 eurosh që i korrespondon grantit dhe këtu quhet “Granti” për t’u disbursuar në një kësht sipas përshkrimit në shtojcën A.

1.2 CEB-i e depoziton shumën e grantit në një llogari të veçantë të hapur në Bankën Qendrore të Shqipërisë nga MF-ja.

MF-ja i kalon të gjitha shumat nga kontributi i CEB-it nëpërmjet një llogarie projekti të hapur në një bankë tregtare nga MF-ja dhe të destinuar vetëm për këtë projekt. ADF-ja (shih 4.2) do të autorizohet të operojë llogarinë e projektit. Të gjitha veprimet do të autorizohen, regjistrohen dhe raportohen nga ADF-ja bazuar në marrëveshjen e transferimit që duhet të nënshkruhet nga MF-ja dhe ADF-ja.

1.3 Granti do të paguhet në euro. Të gjitha llogaritë dhe pasqyrat financiare do të shprehen në euro.

Neni 2

Kushtet për përdorimin e grantit

2.1 Granti i ofruar nga CEB-i do të përdoret përjashtimisht për qëllimin për të cilin është planifikuar (shtojca A).

2.2 Çdo ndryshim i konsiderueshëm në projekt i nënshtrohet pëlqimit me shkrim të CEB-it para se këto ndryshime të përfshihen në projekt. Nëse bëhen ndryshime që, sipas mendimit të CEB-it, mund të dëmtojnë ndikimin e projektit, CEB-i rezervon të drejtën të pezullojë, anulojë ose kërkojë shlyerjen e menjëhershme të grantit.

2.3 MF-ja nëpërmjet ADF-së tregon të gjithë kujdesin dhe vëmendjen, dhe ushtron të gjitha mjetet që përdoren zakonisht, veçanërisht mjetet financiare, teknike, sociale dhe menaxheriale që do të jenë të nevojshme për administrimin e duhur të grantit.

2.4 Çdo shumë që mbetet e papërdorur me përfundimin e projektit sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë çdo interes që i takon grantit, i kthehet CEB-it në euro, nëse nuk bihet dakord ndryshe.

Neni 3

Përgjegjësia për projektin

3.1 Marrësi cakton ADF-në për menaxhimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e projektit. Megjithatë, përgjegjësia për të përbushur të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje i mbetet marrësit.

3.2 ADF-ja ka përgjegjësinë për fondet e marra nga CEB-i, ekzekutimin dhe mbikëqyrjen e projektit dhe mban CEB-in dhe MF-në të informuar për progresin e projektit, duke i dhënë CEB-it raporte, siç përcaktohet më tej në nenin 6 më poshtë.

Neni 4

Zbatimi i projektit

4.1 Granti do të mbulojë deri në 100% të të gjithë kostos së projektit, siç përshkruhet në shtojcën A. CEB-i nuk merr përsipër të mbulojë asnjë shpenzim tej kësaj shume të grantit prej 180 000 eurosh.

4.2 Marrësi garanton që ADF-ja do të përdorë grantin e CEB-it në pajtim me procedurat e projektit F/P 1665 (2009), duke përfshirë tenderimin, prokurimin, monitorimin e punimeve.

4.3 Nëse priten ose realizohen shtesa të paparashikuara në shpenzime apo detyrime (qoftë për shkak të faktorëve të inflacionit, luhatje në normën e këmbimit ose masa të paparashikuara), MF-ja siguron që ADF-ja do të informojë rregullisht CEB-in në kohën e duhur për rritjet.

Neni 5

Llogaritë

5.1 ADF-ja do të mbajë regjistra llogarish në lidhje me projektin, që do të jenë në pajtim me standardet ndërkombëtare, të cilat tregojnë në çdo kohë gjendjen e përparimit të projektit, dhe që regjistron të gjitha operacionet e kryera me ndihmën e këtij granti. Granti i CEB-it u nënshtrohet procedurave të brendshme dhe të jashtme të auditimit të parashikuara në rregulloret, rregullat dhe direktivat financiare të zbatueshme për ADF-në dhe për projektin F/P 1665.

Neni 6

Monitorimi dhe raportet

6.1 MF-ja siguron që raportimi i ADF-së mbi shpenzimet e kryera do të shprehet në euro ose, nëse pagesat bëhen në një monedhë tjetër, duke konvertuar shumat përkatëse të paguara në euro sipas normës përkatëse të këmbimit në ditën e pagesës për kontraktorin në monedhën jo-euro.

6.2 MF-ja siguron që ADF-ja i paraqet CEB-it raporte të përgatitura në pajtim me procedurat ndërkombëtare për llogaritë dhe raportimin.

6.3 MF-ja siguron që ADF-ja t'u paraqesë CEB-it dhe MF-së raporte mujore pas datës së nënshkrimit dhe një raport përfundimtar me përfundimin e aktiviteteve të mbështetura nga ky grant. Raporti përfundimtar përfshin një vlerësim të aktiviteteve dhe një raport financiar. Ky raport përfundimtar duhet të jetë i pranueshëm për CEB-in.

6.4 MF-ja siguron që ADF-ja t'u mundësojë përfaqësuesve të CEB-it akses në dokumentimin e projektit, duke përfshirë regjistrat e llogarive në lidhje me projektin.

Neni 7
Njoftimet

7.1 Çdo njoftim që duhet t'i bëhet njërës palë në lidhje me këtë Marrëveshjeje u jepet ose u dërgohet efektivisht me letër ose faks palëve në adresat e mëposhtme. Adresa e secilës palë mund të ndryshohet me njoftim në mënyrën e parashikuar në këtë dispozitë.

7.2 Çdo njoftim drejtuar CEB-it dërgohet në adresën e mëposhtme:

Drejtor i përgjithshëm për huatë
Council of Europe Development Bank
55, Avenue Kléber
75784 Paris Cedex 16 – France
Faks: 33 1 47 55 37 52

Çdo njoftim për MF-në dërgohet në adresën e mëposhtme:

Ministria e Financave
Blvd.: “Dëshmorët e Kombit”, Nr.1, Tiranë, Shqipëri
Në vëmendje të: Ministrit të Financave
Faks: + (355 4) 22 84 94

Neni 8
Ndryshimet

8.1 Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me ndryshime formale nga CEB-i dhe MF-ja, secila prej të cilave i kushton vëmendjen e plotë çdo propozimi të paraqitur për ndryshim.

Neni 9
Mosmarrëveshjet

9.1 Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve të kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohen arbitrazhit, sipas kushteve të përcaktuara në kapitullin 4 të rregulloreve të CEB-it për huatë.

Neni 10
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Marrëveshjes

10.1 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga palët dhe pas përfundimit të procedurave përkatëse ligjore në Republikën e Shqipërisë.

10.2 Marrëveshja pushon së qeni në fuqi tridhjetë ditë pasi njëra prej palëve t'i ketë bërë njoftim me shkrim palës tjetër për vendimin e saj për ta prishur këtë Marrëveshje për shkaqet e arsyetuara në mënyrën e duhur.

10.3 Marrëveshja pushon së qeni në fuqi pas ndodhjes së ngjarjeve të mëposhtme:

- Disbursimi nga CEB-i i grantit të plotë për marrësin;
- Përdorimi i plotë i grantit ose kthimi i mundshëm tek CEB-i nga Marrësi i çdo shume të mbetur të pashpenzuar pas përfundimit të projektit;
- Paraqitja e një raporti përfundimi nga ADF-ja tek CEB-i, si dhe pranimi i këtij të fundit dhe i MF-së për këtë raport përfundimi, sipas përkufizimit në § 6.3 më sipër.

Në dëshmi sa më sipër, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në gjuhën angleze, në dy kopje origjinale.

SHTOJCA A
PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT

Projekti	Asistencë teknike për komponentin e monitorimit dhe vlerësimit të projektit për rrugët dytësore dhe lokale, duke përfshirë përpunimin dhe transferimin në një udhëzim metodologjik praktik për monitorimin dhe vlerësimin (GMME) dhe planin e transparencës së projektit (PVP).		
Vendi	Shqipëri		
Agjencia zbatuese	ADF-ja		
Përfituesit	Personeli i ADF-së do të përfitojë nga hartimi i një metodologjie për mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave dhe më vonë rritjen e kapaciteteve në realizimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha projekteve në zbatim. Personeli i ADF-së do të përfitojë nga trajnimi në fushat e ndryshme në lidhje me menaxhimin dhe zbatimin e projektit.		
Shuma e grantit	180 000 euro		
Buxheti i vlerësuar	Vlerësimi i kufirit për komponentët		Shuma (€)
	1. Asistencë teknike (shërbimet e konsulencës)		90,000
	2. Trajnime (organizime, shërbime etj.)		35,000
	3. PVP (komunikimi, seminarët, informacioni, materialet etj.)		55,000
	Totali		180,000
	Shuma për komponent mund të ndryshojë me Marrëveshjen e CEB-it dhe grantit.		
Periudha e zbatimit	Burimet e grantit do të shpenzohen sipas zbatimit të projektit F/P 1665		
Aktivitet e planifikuara	1. Asistenca teknike ADF-ja do të kontrakttojë shërbimet e konsulencës për zhvillimin dhe transferimin e aktiviteteve lidhur me GMME-në. Detyra do të mbulojë asistencën për përgatitjen e metodologjisë së monitorimit dhe vlerësimit, trajnimin e stafit dhe përpunimin e GMME-së. Buxheti i llogaritur prej 90,000 € do të përfshijë pagesat dhe rimbursimet (transporti dhe banesa të marra me qira) për ekspertët ndërkombëtarë. 2. Trajnimet Ky komponent do të përfshijë dy tipe trajnimesh : i) për monitorimin dhe vlerësimin dhe ii) për informimin dhe komunikimin. Në të dyja raste kurset e trajnimit do të ndiqen nga pjesëtarët e stafit për Njësinë e Monitorimit dhe Vlerësimit dhe përkatësisht Njësinë e Komunikimit të ADF-së. 3. Plani i realizueshmërisë së projektit Detajet e PVP-së dhe veçanërisht në përmbajtjen e materialeve të komunikimit, temat e seminareve dhe workshop-eve etj., do të përgatiten nga stafi i ADF-së, nëpërmjet kompetencave të zhvilluara gjatë projektit. Buxheti për aktivitetet e PVP-së mund të përfshijë, jo ekskluzivisht, aktivitetet e mëposhtme: -Seminare informuese lidhur me qendrat rajonale me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga qeveria lokale dhe nga media lokale. -Konferenca në Tiranë me pjesëmarrjen e pritshme të palëve të interesuara, donatorëve kryesorë, pjesëmarrësve nga qeveria dhe media kombëtare. -Publikimi i i broshurave dhe materialeve informative dhe posterave. -Spotet televizive të përgatitura nga një agjenci e specializuar, e cila do të kontraktohet nga ADF-ja.		

Ndikimet sociale	Projekti i rrugëve dytësore dhe lokale është një projekt shumë i rëndësishëm për përmirësimin e jetës së banorëve në zonat rurale. Rindërtimi i rrugëve rezistente ndaj motit konsiderohet të jetë një nga arsyet kryesore për zbutjen e varfërisë në zonat rurale dhe asistencë teknike në monitorimin dhe vlerësimin do të ndihmojë për të vlerësuar ndikimet e saj mbi përfituesit. Edhe trajnimi i ADF-së do të ndihmojë të përmirësojë menaxhimin e projektit duke kontribuar në zbatimin e suksesshëm.
Procedurat e disbursimit	CEB-i do të disbursojë grantin minimalisht në dy transhe. Shuma e secilit transh do të përcaktohet sipas gjendjes së progresit të punimeve, d.m.th. proporcionalisht në shpenzime tashmë të pranueshme, në lidhje me aktivitetin e komponentit të lartpërmendur, në buxhetin total. Transhi i parë nuk mund ta tejkalojë 50 % e buxhetit të miratuar. Çdo transh pasues mund të disbursohet vetëm pasi ADF-ja t'i konfirmojë me shkrim CEB-it, që 90 % e transhit të mëparshëm është alokuar.

VENDIM
Nr.891, datë 19.8.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË KOMUNËN POLIS TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Polis të qarkut të Elbasanit, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 64 (gjashtëdhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 405 (katërqind e pesë).

2. Ndryshimet, që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.894, datë 19.8.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS NDROQ TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Ndroq të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Ndroq të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.478, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Ndroq të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Ndroq për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Ndroq

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
2,3	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
4-12	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
13-25	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
26,37	Varreza publike	Në pronësi
38-50	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën ekonomike.	Në pronësi
176-286,331-425	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
309,311,313,315,317, 319, 321, 323, 325,327,329	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
310,314,316,318, 320,322, 324,326,328,330	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
426	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr.895, datë 19.8.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NË KOMUNËN KELMEND TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Kelmend të qarkut të Shkodrës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 250 (dyqind e pesëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 2 041 (dy mijë e dyzet e një).

2. Ndryshimet, që mund t’i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.1547, datë 27.8.2009

PËR NIVELIN E KUOTAVE TË SHPENZIMEVE PËR USHQIME, NË INSTITUCIONET
PUBLIKE REZIDENCIALE E KOMUNITARE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 24 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për klientët, që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror është:

- | | |
|--|-----------|
| a) për fëmijët e vendosur në shtëpinë e foshnjës 0-3 vjeç | 290 lekë; |
| b) për fëmijët e vendosur në shtëpinë e fëmijës 3-6 vjeç | 300 lekë; |
| c) për fëmijët e vendosur në shtëpinë e fëmijës 6-15 vjeç | 320 lekë; |
| d) për personat e vendosur në qendrat e zhvillimit | 330 lekë; |
| e) për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve | 280 lekë; |
| f) për klientë në qendrat pritëse, rehabilituese dhe riintegruese për viktimat e trafikimit sipas kategorive të përfituesve të përcaktuara në germet “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e” të këtij udhëzimi. | |

2. Niveli i kotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për klientët, që përfitojnë shërbime në qendra ditore publike të përkujdesit shoqëror është:

- | | |
|------------------------------------|-----------|
| a) në qendra ditore polivalente | 150 lekë, |
| b) në qendrat ditore të zhvillimit | 210 lekë, |
| c) në shtëpinë e foshnjës 0-3 vjeç | 200 lekë. |

3. Niveli i kuotës për shpenzimet ditore ushqimore për kuzhinierët dhe ndihmëskuzhinierët, që punojnë në këto institucione, është i barabartë me 60% të kuotës financiare ditore për ushqim, për kategoritë e përfituesve të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij udhëzimi.

4. Efektet financiare nga rritja e nivelit të kuotës financiare të shpenzimeve për ushqim, përballohen nga fondet e buxhetit qëndror, të programuara për shërbimet e përkujdesit shoqëror për vitin 2010.

5. Udhëzimi nr.303, datë 13.2.2007 “Për nivelin e kotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi më 1.1.2010.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE
SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Viktor Gumi

URDHËR
Nr.642, datë 25.9.2009

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.325, datë 21.5.2003 “Për pozicionin, detyrat dhe përgjegjësitë e sekretarit të përgjithshëm në ministri”,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Brendshme në proceset gjyqësore, të lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

2. Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore të jetë sipas lidhjes nr.1 të këtij urdhri.

3. Për autorizimet e lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm deri në miratimin e këtij urdhri të ri, të cilat janë përdorur ose përdoren për përfaqësim në proceset gjyqësore, efektet e urdhrit nr.1723, datë 15.11.2007 “Për delegim kompetence”, do të shtrihen edhe pas miratimit të këtij urdhri të ri.

4. Për autorizimet e lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm pas miratimit të këtij urdhri të ri, do të gjejë zbatim ky i fundit.

5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Lulzim Basha

Lidhja nr.1

Modeli i autorizimit për përfaqësimin në proceset gjyqësore



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 200_

AUTORIZIM

PËR PËRFAQËSIMIN NË ÇËSHTJEN CIVILE ME PALË:

Paditës:

I paditur:

Në mbështetje të neneve 64-77 të Kodit Civil, të nenit 96 të Kodit të Procedurës Civile, dhe të urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. _____, datë ____ . ____ . 2009 “Për delegim kompetence”,

VENDOSA:

Autorizimin e z. _____, [titulli i pozicionit] në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike, për të hartuar, nënshkruar dhe dorëzuar kërkesëpadinë [ankimin/rekursin kundër vendimit nr. _____, datë ____ . ____ . 200_, të Gjykatës së _____], si dhe për të përfaqësuar Ministrinë e Brendshme në të gjitha seancat gjyqësore të çështjes civile me objekt “_____”, deri në shpalljen e vendimit në Gjykatën e _____.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

URDHËR
Nr.666, datë 3.8.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE DHE KRITEREVE TË SIGURISË, TË PËRKOSSHME, PËR KËRKESAT MINIMALE TË PROJEKTIMIT TEKNIK, NDËRTIMIT DHE OPERIMIT TË SISTEMEVE TË TRANSMETIMIT E TË SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR, TË INSTALIMEVE TË GNL-SË, HAPËSIRAVE TË DEPOZITIMIT DHE TË LINJAVE DIREKTE

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”,

URDHËROJ:

1. Për operimin e sigurt të sistemeve të gazit natyror, kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, të hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte, do të bazohen në rregullat dhe kriteret e sigurisë që janë në fuqi në Itali dhe/ose Greqi.

2. Çdo subjekt i interesuar për ndërtimin dhe operimin e sistemeve të gazit natyror dhe që do të paraqesë për miratim një projekt teknik të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, të hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte, është i detyruar që të prezantojë edhe se cilat do të jenë rregullat teknike dhe kriteret e sigurisë që do të zbatohen gjatë projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të gazit natyror.

3. Strukturat përgjegjëse për sektorin hidrokarbur në ministri, mund të kërkojnë marrjen e opinionit dhe vlerësimit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për propozimin e paraqitur nga subjekti i interesuar, lidhur me rregullat teknike dhe kriteret e sigurisë që do të zbatohet ky subjekt gjatë projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të gazit natyror.

4. Rregullat dhe kriteret e sigurisë të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri do të zbatohen deri në miratimin e rregullave teknike dhe kriterëve të sigurisë nga Këshilli i Ministrave siç parashikohet nga pika 1 e nenit 7 të ligjit nr.9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”.

5. Operimi i infrastrukturës ekzistuese të gazit natyror do të jetë objekt i rregullave teknike dhe kriterëve të sigurisë që kanë qenë në fuqi në Republikën e Shqipërisë para daljes së këtij vendimi.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen strukturat përgjegjëse për sektorin hidrokarbur në ministri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori).
 Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
 Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë

Hyri në shtyp më 28.9.2009
 Doli nga shtypi më 30.9.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
 Tiranë, 2009

Çmimi 16 lekë